Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

938/19
Datë/Date 27.01.20

PSH .nr. 938/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: "Engineering Group" Shpk&"Çeta–Genera Invest Group"-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan" me nr. të prok:631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Deçan, më datën:15.01.2020, mori këtë:

U R DH Ë R E S Ë

I. <u>APROVOHET</u>, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan" me nr. të prok:631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Deçan.

II. <u>OBLIGOHET</u>, autoriteti kontraktues Komuna Deçan, që të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSH nr. 755/19, i protokolluar me datë: 03.12.2019, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan" me nr. të prok:631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Deçan.

III. <u>URDHËROHET</u>, autoriteti kontraktues Komuna Deçan, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në, dhe operatorin ekonomik "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan, lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së, me numër PSH.nr. 755/19, i protokolluar me datë: 03.12.2019, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan" me nr. të prok:631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Deçan.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej pesë ditë kalendarike, do ta detyroj Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së, dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së / Komuna Deçan / sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan aprovohet si e bazuar, të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.12.2019 me nr. 938/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan" me nr. të prok:631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Deçan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e datës: 26.12.2019, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60 të LPP-së Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017

të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara "res judikata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 61 të LPP-së, dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK-ja me datë 06.12.2019, ka kërkuar sqarim me shkrim grupit te OE: "Engineering Group" Shpk&"Çeta–Genera Invest Group"-Deçan, sqarime rreth pozicionit 1.2, 3.11, 3.12, 3.13 dhe 3.14. Ndërsa OE: "Engineering Group" Shpk - Deçan me datë 08.12.2019, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, ka kthyer përgjigje, po citoj: "Ne ju informojmë se me rastin e ofertomi ne kemi vlerësuar me përgjegjësi dhe hollësi secilin pozicion dhe çmimet qe ne i kemi ofruar janë çmime te arsyeshme dhe te realizueshme për arsye se ne ndonjë pozicion te caktuar (pos. E cekura nga ju: 1.2, 3.11, 3.12, 3.13 dhe 3.14) mund te ketë edhe çmime te lira por ka pozicione tjera qe kane vlere te konsiderueshme dhe si te tersi e mbulojnë njëra tjetrën. Ne kemi ofruar këto çmime pasi dëshirojmë qe sasitë e grumbulluara ti harxhojmë me këtë kontrate, kurse diferenca e çmimit nga ajo qe shihet ne treg plotësohet me pozicionet tjera qe kane çmime relativisht te mëdha. Gjithashtu, nëse autoriteti kontraktues ka me te voglin dyshim atëherë ne mënyrë qe te sigurohet edhe me shume ne mund te paguajmë edhe sigurimin shtese te ekzekutimi." OE "Engineering Group" Shpk – Deçan, nuk ka bashkëngjit asnjë dëshmi/prove se i posedon këta produkte/artikuj ne stok. Gjithashtu, duke marr për bazë edhe Lista e çmimeve njësi mesatar referent për punë ndërtimore dhe materiale ndërtimore nga web faqja e KRPP-se, si dhe OE ankues se bashku me ankese, ka bashkëngjit prova fatura lidhur me çmimet ne treg për këto pozicione nga 3 (tri) kompani te ndryshme.

Mirëpo, AK vet e vlerëson nëse një tender është jo-normalisht i ulet, konsideroj se AK nuk ka respektuar nenin nenit 61 paragrafit 4 të LPP-se, ku thuhet: "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin". Mirëpo, pavarësisht nga ky sqarim si me lart përgjegjësia bie mbi autoritetin kontraktues, për te trajtuar një tender apo një pozicion te tenderit si jo-normalisht të ulët. Prandaj, në bazë të analizës se mësipërme sqarojë/konsideroj se pretendimet e palës në ankese janë të qëndrueshme.

Eksperti Shqyrtues sqaron si ne vijim: Është përgjegjësi, dhe obligim i autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, te trajtoj dhe analizoje çmimin, apo

te konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57, Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht te Ulët.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 28.12.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues, duke pasur parasysh dëshmitë që i ka pasur në dispozicion, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues Komuna Deçan, nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së, PSH.nr 755/19, i protokolluar me datë: 03.12.2019, ku është vendosur që të "aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan, lidhur me aktivitetin e

prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan" me nr. të prok:631-19-6725-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Deçan, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60 të LPP-së Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), vlerëson se janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë. Lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara "res judikata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 61 të LPP-së, dhe Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, autoriteti kontraktues me datë 06.12.2019, ka kërkuar sqarim me shkrim nga grupit i OE-ve: "Engineering Group" Shpk&"Çeta–Genera Invest Group"-Deçan, sqarime rreth pozicionit 1.2, 3.11, 3.12, 3.13 dhe 3.14. Ndërsa OE: "Engineering Group" Shpk - Deçan me datë 08.12.2019, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, ka kthyer përgjigje, në të cilën thuhet: "Ne ju informojmë se me rastin e ofertomi ne kemi vlerësuar me përgjegjësi dhe hollësi secilin pozicion dhe çmimet qe ne i kemi ofruar janë çmime të arsyeshme dhe të realizueshme për arsye se ne ndonjë pozicion te caktuar (pos. E cekura nga ju: 1.2, 3.11, 3.12, 3.13 dhe 3.14) mund të ketë edhe çmime te lira por ka pozicione tjera qe kane vlere te konsiderueshme dhe si te tersi e mbulojnë njëra tjetrën. Ne kemi ofruar këto çmime pasi dëshirojmë qe sasitë e grumbulluara ti harxhojmë me këtë kontrate, kurse diferenca e çmimit nga ajo qe shihet në treg plotësohet me pozicionet tjera qe kane çmime relativisht te mëdha. Gjithashtu nëse autoriteti kontraktues ka me te voglin dyshim atëherë ne mënyrë qe te sigurohet edhe me shume ne mund te paguajmë edhe sigurimin shtese te ekzekutimi." OE "Engineering Group" Shpk – Deçan, nuk ka bashkëngjit asnjë dëshmi/prove se i posedon këta produkte/artikuj ne stok. Gjithashtu, duke marr për bazë edhe LISTA E ÇMIMEVE NJËSI MESATAR REFERENT PËR PUNË NDËRTIMORE DHE MATERIALE NDËRTIMORE nga web faqja e KRPP-se, si dhe OE ankues se bashku me ankese, ka bashkëngjit prova fatura lidhur me çmimet ne treg për këto pozicione nga 3 (tri) kompani të ndryshme.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron, se autoriteti kontraktues vet e vlerëson nëse një tender është jo-normalisht i ulet, andaj autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 paragrafit

4 të LPP-se, në të cilin thuhet: "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin". Mirëpo, pavarësisht nga ky sqarim si me lart përgjegjësia bie mbi autoritetin kontraktues, për të trajtuar një tender apo një pozicion te tenderit si jo-normalisht të ulët. Andaj pretendimet e palës në ankese janë të qëndrueshme.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron, është përgjegjësi, dhe obligim i autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoje çmimin, apo te konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura dhe rregullave ku janë të publikuar në web-faqen e KRPP-së, në formularin B57, Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht te Ulët.

Paneli shqyrtues konstaton se kjo çështje është "Res Judicata" apo çështje e gjykuar ne vendimin PSH.nr. 755/19 të datës 03.12.2019.

Paneli shqyrtues me vendimin PSH.nr.755/19, i protokolluar me datë: 03.12.2019,vlerëson se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarime nga OE lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta e as OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë sqarime të hollësishme dhe të detajuar para panelit shqyrtues se si do të realizoj këtë kontratë me çmimet e ofruara ashtu siç parashihet në dispozitat ligjore të LPP-së, dhe akteve nënligjore për prokurim publik, prandaj obligohet autoriteti kontraktues qe gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me çmimet e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë . Andaj, Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit duhet të ketë parasysh paragrafin 4.4 të nenit 4 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike duke marrë në konsiderata qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, dhe ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi e tenderëve ta bëjë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Prandaj duke u nisur nga faktet e cekura si me lart autoriteti kontraktues obligohet të respektoj vendimin e mëparshëm të panelit shqyrtues PSH.nr 755/19, i protokolluar me datë: 03.12.2019.

Andaj, ju bëjmë me dije se vendimet e OSHP-së, janë të obligueshme për tu zbatuar nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët kanë të drejt ti

drejtohen gjykatës kompetente brenda afatit ligjor me anë të mjeteve të rregullta juridike, konform këshillës juridike të dhënë në vendim.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 dhe 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të kësaj urdhërese.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

_____

z. Blerim DINA

Urdhëresa t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Deçan

1x1 OE - "NB. PROJEKT SH.P.K & N.P.N ALPING & ALPING SH.P.K" - Deçan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.